

KONTRATE DHURIMI

Sot më datë 11/01/2024 (dymijë e njëzetë e katër), lidhet kjo kontratë dhurimi aksionesh ("Kontrata") ndërmjet palëve të mëposhtëme, (veçmas referuar si "Pala" dhe në numrin shumës si "Palët"):

PALËT:

Z. Blendi GONXHJA, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, më 15/06/1970, banues në Tiranë, me Nr personal H00615077V, këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar si "Dhuruesi i aksioneve"

dhe

Zj. Elda GONXHJA, shtetase shqiptare, lindur ne Gjirokastrë, më 22/10/1974, me nr personal H46022086M, këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar si "Pranuesi i Dhurimit të aksioneve"

Kjo kontratë dhurimi aksionesh është lidhur duke patur parasysh vullnetin e lire dhe te plotë të palëve për transferimin e aksioneve të shoqërisë tregtare ALBARENT Shpk.

Sa më sipër, palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë:

MEQËNËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE:

Shoqëria Tregtare "Albarent" shpk. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka fituar personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar me numër identifikimi NIPT K92108006A. Shoqëria ka një kapital prej 100000 të regjistruar, nënshkruar dhe derdhur, e zotëruar nga aksionaret, sipas Ekstraktit tregtar te QKB-së, në këtë mënyrë:

Z. Blendi GONXHJA zotëruar i 100% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë nominale 100,000 lekë;

Dhuruesi i aksioneve në këtë kontratë, z. Blendi Gonxhja, me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë, sipas marreveshjeve paraprake të palëve dhe permbajtjes se Vendimit te Asamblese, datë 10.01.2024, ka vendosur të transferojë, në total, pjesën e tij të aksioneve, që zotëron pranë shoqërisë, tek Pranuesi i dhurimit.

Znj. Elda Gonxhja.

Pranuesi i Dhurimit në këtë kontratë, shtetasja Znj. Elda Gonxhja, është dakort të pranojë dhurimin në masën prej 100% të aksioneve që zotëron aksioneri Z.Blendi Gonxhja në kapitalin e Shoqërisë.

Nëpërmjet realizimit të këti veprimi juridik, pranuesi i dhurimit do të fitojë, cilësinë e aksionerit të vetëm të Shoqërisë, dhe do të zotërojë masën prej 100% te aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërise "ALBARENT" shpk.

Dhuruesi, Z. Blendi Gonxhja, pas transferimit të masës totale të aksioneve tek pranuesi i dhurimit Znj. Elda Gonxhja, do të humbasë cilësinë e aksionerit në shoqëri, duke humbur të drejtën e pronësisë.

Kjo Kontratë vendos termat dhe kushtet sipas së cilave Dhuruesi do të transferojë dhe pranuesi i dhurimit do të pranojë AKSIONET që janë objekt i termave dhe kushteve të kësaj Kontrate:

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, PALËT me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakort si më poshtë:

NENI 1

PËRKUFIZIME

Përveç termave të tjera të përkufizuara posaçërisht në ndonjë dispozitë të kësaj Kontrate, për qëllimet të interpretimit dhe zbatimit të saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“**Kontratë**” do të thotë kjo Kontratë për transferimin e Aksioneve nëpërmjet dhurimit (në reference neni 117/1/3 të Ligjit Tregtar), duke përfshirë si një pjesëpërbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, të shkëmbyera ndërmjet Dhuruesit dhe pranuesit të dhurimit;

“**Transferimi**” do të thotë dhurimi dhe pranimi i dhurimit të Aksioneve, në përgjithësi, pranimi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumentave të nevojshme, dhe kryerja, përmbushja e gjithë detyrimeve, për Transferimin në përputhje me këtë Kontratë;

“**Data e Transferimit**” do të thotë data në të cilën aksionet janë Transferuar nga Dhuruesi te pranuesi i dhurimit, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.

“**Palë**” do të thotë Dhuruesi ose Pranuesi i Dhurimit ose të dy së bashku, siç e kërkon përmbajtja e kësaj kontrate;

“**Shoqëria**” do të thotë shoqëria tregtare “ALBARENT” shpk.

“**Vendim i Shoqërisë**” do të ketë kuptimin e Vendimit të marrë nga organi kompetent i shoqërisë “ALBARENT” shpk, më datë 10/01/2024, dhe nëpërmjet të cilit është miratuar realizimi i procedurës së transferimit të aksioneve.

Termat dhe fjalët e përdorura në numrin njëjës në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim dhe në rast se do të përdoren në numrin shumës.

NENI 2

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është transferimi nga Dhuruesit tek Pranuesi i Dhurimit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë kontratë, 100%, të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar dhe çdo të drejtë që u përket ketyre Aksioneve, në gjendje si janë.

Aksionet që do të transferohen, objekt i kësaj kontrate, përfaqësojnë në total masën prej 100% të kapitalit të shoqërisë.

Aksionet do të transferohen nëpërmjet dhurimit nga aksioneret e shoqërisë:

- Z. Blendi Gonxhja, do të transferojë 100%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë me vlerë nominale 100,000 lekë.

NENI 3

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Aksionet e transferuara sipas kësaj kontrate kalojnë në pronësi të pranuesit të dhurimit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Dhuruesi, humbet totalisht pronësinë e aksioneve që zotëron në shoqërinë "ALBARENT" shpk në masën prej 100% të aksioneve, që zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë.

Ndërsa, Pranuesi i dhurimit Znj. Elda Gonxhja, bëhet pronar i masës prej 100% të aksioneve të kapitalit duke fituar në të njëjtën kohë dhe cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë "ALBARENT" shpk

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë "ALBARENT" shpk, do të zotërohet nga aksionari i vetëm, në këtë mënyrë:

Znj. Elda Gonxhja, në cilësinë e aksionerit të totem aksioneve, do të zotërojë 100% të kopitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 100,000 (njqind mije) Lekë.

NENI 4

DETYRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN

Përveç ndonjë veprimi tjetër për tu ndërmarrë dhe të ndonjë instrumenti tjetër për tu nënshkruar dhe/ose dorëzuar në përputhje me këtë Kontratë, për *transferimin* e aksioneve:

Dhuruesi do të:

Dorëzojë të gjithë dokumentacionin ligjor të shoqërisë me të cilin vërtetohen nënshkrimi rregullisht dhe shlyerja e aksioneve të kapitalit themeltar;

Nënshkruajë dhe dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e instrumentave të tjera që mund të jenë të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për ti kaluar pranuesit të dhurimit pronësinë e në gjendjen si është, pamvarësisht pretendimeve nga persona fizik apo juridike, privatë apo publikë që janë apo mund të lindin në të ardhmen.

Dorëzojë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe financiar të shoqërisë në disponim të kësaj të fundit.

Dhe

Pranuesi i dhurimit:

Do të marrë në dorëzim të gjithë dokumentacionin e shoqërisë sipas përcaktimeve të këtij neni.

Në përfundim, pranuesi i dhurimit fiton titullin mbi Aksionet në datën e Transferimit dhe po në këtë datë do të fitojë dhe cilësinë e aksionerit të vetëm të Shoqërisë duke zotëruar 100% të aksioneve të kapitalit themeltar, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi Aksionet e përfituara.

NENI 5

DETYRIME SPECIFIKE TË PALËVE

Palët në këtë kontratë deklarojnë se sipas marrëveshjes paraprake të arritur mes tyre, pranuesi i dhurimit ka fituar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet e shoqërisë, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

NENI 6

DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

Dhuruesi deklaron dhe i garanton pranuesit të dhurimit sa më poshtë;

Shoqëria "Albarent" shpk është një Shoqëri e organizuar dhe që funksionin në bazë të ligjislacionit Shqipëtar dhe ka dhe kompetencë të plotë për të drejtuar veprimtarinë e saj, të zotërojë pronat dhe aktivet që ka tashmë në zotërim. Shoqëria është licensuar sipas rregullave në fuqi të kryejë veprimtari sipas objektit të saj të përcaktuar në Statutin e shoqërisë. Dhuruesi garanton se nuk do të ketë asnjë ndryshim në dokumentat ligjor të shoqërisë, përsa i përket akteve të saj të themelimit dhe veprimeve të posaçme në lidhje me lejet apo liçensat përkatëse deri në datën e Transferimit.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë në datën e transferimit është 100000 lekë. Gjithë Aksionet e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë janë shlyer tërësisht.

Nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor i formës së prerë të çdo shkalle gjykimi, vendim administrativ, për hapjen e ndonjë procedurë falimentimi apo likuidimi.

NENI 7

DEKLARIMET DHE GARANCITË E PËRFITUESIT TË DHURIMIT TË AKSIONEVE

Pranuesi i dhurimit deklaron dhe garanton Dhuruesin si më poshtë:

6

Pranuesi i dhurimit është një person fizik (shtetas) i padënuar asnjëherë, me reputacion dhe aftësi të konsiderueshme në fushën tregtare.

Pranuesi i dhurimit ka fuqi dhe të plotë për të hyrë në këtë Kontratë. Pranuesi idhurimit ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të përfunduar këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e miratuara në të.

NENI 8

SHPENZIMET DHE TATIMET

8.1- Të gjitha shpenzimet që lidhen me paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji të Vendimeve, dokumentave ligjore dhe dokumentave të tjera të cilat i bashkëlidhen kësaj kontrate do të jenë në ngarkim të palës e cila është e detyruar të paraqesë këto dokumenta,

8.2- Shpenzimet tatimore që lidhen me këtë kontratë përsa i përket tatimit mbi të ardhurat (të tatimit mbi transferimin e aksioneve), do të mbulohen nga Pala Dhuruese në këtë kontratë, në konformitet me legjislacionin fiskal shqiptar në fuqi.

NENI 9

LIGJI QË DO TË ZBATOHET

9.1. Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqinë Republikën e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit tregtar dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

9.2. Zgjidhja e konflikteve ndërpalëse

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo do shkelje që rrjedh prej këtej do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të palëve në këtë kontratë. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10
TË NDRYSHMIE

10.1. Hyrja në fuqi kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët respektive.

10.2 Ndryshimi i kushteve kontraktore.

Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të përfunduar mes Palëve.


NENI 11
GJUHA E KONTRATËS

11. Kjo Kontratë është e përbërë nga 7(shtatë) fletë, dhe është përgatitur në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PALËT

DHURUESI

Z. Blendi Gonxhja



PRANUESI

Znj. Elda Gonxhja

